

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “ MIHAL SHAHINI ” CERRIK**

Nr. 315 prot.

Cerrik, më 19/08/2025

Lënda: Shpallje e vendit të lirë për lëvizje paralele

Drejtuar : **AGJENCISË KOMBETARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE (AKPA)**

Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore

Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun

TIRANE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “ Për nxitjen e punësimit” ; të ligjit nr. 15/2017, “ Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ”; të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 554 , datë 31.7.2019 “ Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” ; të Udhëzimit Nr.759, datë 30.09.2024 “ Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit profesional si dhe aspekte të menaxhimit të burimeve , përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”,

Ofruesi publik i AFP-së , Shkolla e Mesme Profesionale ” Mihal Shahini ” Cerrik , ju njofton krijimin e vendit të lirë për lëvizje paralele për pozicionin


1(një) vend për **Specialist i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit .**

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:



- a) të ketë të paktën nivelin arsimor Bachelor në fushën e shkencave të natyrës në përputhje me profilin e shpalljes së pozicionit përkatës .
- b) të ketë të paktën 1 vit përvojë pune , sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës.
- c) të ketë aftësi didaktiko - pedagogjike për të mbështetur përdoruesit në aplikimin e platformave, aplikacioneve dhe teknologjive arsimore në mësimdhënie, mësimnxënie.

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar , sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë :

- a) letërmotivimin për pozicionin ;
- b) jetëshkrimin (CV-në);
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën ;
- e) librezën e punës ;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet , trajnimet apo të tjera të përmendura në CV ;
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit ;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore ;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore ;
- j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit , që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi ;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre .

Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda datës 28.08.2025.

DREJTOR I SHKOLLËS

ERINA DISHO

